

Miratohet

Kryetari i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet  
Minister i Shendetesise  
Petrit VASILI

Sekretari  
Rustem PACI

UDHËZIM

NR. 134 DATE 12-04-2011.

PËR IMPORT EKSPORTIN DHE TRANZITIN E BURIMEVE  
RADIAOKTIVE TË KATEGORIVE  
1 DHE 2 NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Nr 1438/2 prot datë 12-4-2011.

**UDHËZIM**  
**Për import-eksportin dhe tranzitin e burimeve radiaktive të kategorive  
1 dhe 2 ne Republiken e Shqiperise**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, të Nenit 9 pika 2 e Ligjit Nr. 8025, date 9.11.1995, "Per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 158 datë 13 Shkurt 2008 "Për import-eksportin e burimeve te rrezatimit jonizues në Republikën e Shqipërisë, Ministri i Shëndetësisë në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi,

**U D H Ë Z O N :**

Neni 1  
Objekti

Udhezuesi rregullon import-eksportin e materialeve radioaktive prej territorit doganor të Shqipërisë dhe tranzitin nëpër territorin doganor të saj. Tranziti i materialeve radioaktive nëpër territorin e Shqipërisë regullohet nga ky Udhëzues ose me marrëveshje ndërkombëtare.

Burimet radioaktive që do t'i nënshtronen procedurat të import-eksportit janë burimet radioaktive sic e përcaktojne regulloret dhe ligji, si dhe materialet, pajisjet, sistemet ku ato inkorporohen.

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR) përcaktohet si Autoritet Kombëtar në kontrollin e Import-Eksporteve dhe Tranzitit ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 2  
Përkufizime

a-"Eksport" do te thotë transferim fizik , i cili fillon nga një vend eksportues , në vendin importues ose tek një prites në vendin importues ,te nje ose më shumë burimeve radioaktive .

b-"Import" do te thotë transferim fizik ne vendin importues, ose tek një prites ne vendin importues ,i cili ka filluar nga një vend eksportues , të një ose më shume burimeve radioaktive

c-"Pritës " do te thotë një person fizik ose juridik në vendin importues që merr një ose më shumë burime radioaktive të eksportuar nga një vend ose nga një qendër eksportuese në vendin eksportues.

d-"Qendër eksportuese" do të thotë një person juridik ose fizik ne vendin eksportues ,nga i cili nje ose me shume burime radioaktive jane eksportuar në një vend importues ose tek një pritës në vendin importues.

e-"Vend eksportues" do të thotë vendin e origjines së eksportit te një ose më shumë burimeve radioaktive në një vend importues ,ose në një pritës në vendin importues.

f-"Vend importues" do te thote vendi i destinacionit final për transferimin fizik të një ose më shumë burimeve radioaktive nga një vend eksportues ,ose një qendër eksporti.

g- KMR eshte Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet

**APLIKIMI I KETIJ UDHEZUESI**

KMR zbatimin e këtij Udhëzuesi e sheh si një element shtesë në përputhje me aktivitetet për mospërhapjen, sigurinë dhe sigurimin e burimeve radiaktive ,si dhe dhe parandalimin e akteve keqbërëse duke përdorur burime radioaktive.

**APROVIMI I EKSPORTIT**

**KATEGORIA 1 E BURIMEVE RADIOAKTIVE**  
(te ndryshme nga percaktimet e vecanta)

Neni 3

**Aprovimi i KMR**

KMR vendos aprovimin e eksportit ,sic parashikohet më poshtë, për eksportin e burimeve të Kategorise 1, te ndryshme nga rasti i percaktimeve te vecanta. Përpara aprovimit të eksportit të këtyre burimeve ,KMR duhet te marrë aprovimin nga vendi importues. Aprovimi jetet nëpëmjet pikës se kontaktit. KMR, ose subjekti eksportues duhet te njoftojte paraprakisht për eksportin.

Neni 4

## Kerkesa per aprovim eksporti

I. KMR përgatit kërkesën për aprovim për eksportimin e një burimi radioaktiv të Kategorisë 1 dhe njofton me shkrim vendin importues per :

- a. Emrin e Priftësit
- b. Vendodhjen e priftësit, adresën legale, ose vendin kryesor të biznesit
- c. Radionuklidet dhe aktivitetin
- d. Një numër identifikues unik për kërkesën
- e. Afatin e përafert për vodosjen në lidhje me kërkesën

2 .KMR sigurohet që priftësi është i licencuar nga vendi importues për të marrë dhe përdorur burimin në përputhje me ligjet dhe regulloret e tij. Kjo duhet te bazohet në një konfirmim nga vendi importues që priftësi është i licencuar për të marrë dhe përdorur një burim, ose burimet që do të eksportohen, si dhe një kopje të licensës së priftësit.

3. KMR duhet të vleresoje informacionin e mëposhtëm

- a. Emrin e Priftësit
- b. Vendodhjen e pritesit dhe adresen ligjore ose vendin qendror te biznesit.
- c. Te gjithe radionuklidet dhe aktivitetin
- d. Përdorimin ,nqs është i përshtatshëm
- e. Skadimin e afatit të licensës

4. Të sigurohet që vendi importues ka kapacitetet administrative dhe teknike te përshtatshme , burimet dhe strukturën regullatore për të menaxhuar burimet. Vlerësimi nga ana e KMR-se te bazohet në faktin që vendi importues ka vodosur kornizen regullatore që përfshin Kategorinë 1 te burimeve radioaktive e cila ka në funksion elementet e mëposhtëm:

- a. Legjislacionin e mbrojtjes nga rrezatimet dhe rregulloret përkatëse.
- b. Përcaktimin e trupës rregullatore.
- c. Krijimin e një regjistri kombëtar ,ose inventarin e burimeve radioaktive
- d. Krijimin e sistemit të njoftimit, licensimit dhe kontrollit të materialeve radioaktive.

5. Përvec kërkesave të mësipërme, KMR mund të marre në konsiderate për vleresim edhe informacionin e mëposhtëm :

- a. Përgjigjen nga vendi importues për pyetësorin e vetë-vlerësimit(ANEA) .
- b. Nese vendi importues ka shprehur per Drejtoren e Pergjithshem te ANEA që po punohet ne zbatim te Kodit te Drejtimit dhe Udhezuesit perkates te ANEA.
- c. Nese vendi importues qe ka marre pjese ne Projekt Modelin e ANEA's per Ngritjen e Infrastukturës se Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe ka plotesuar piken e pare te ketij projekti

6. KMR per vleresimin ne lidhje me aprovimin e eksportit te mare ne konsiderate informacionin :

- a. Nese pritesi ka qene i perfshire ne prokurime ilegale ose klandestine te materialeve radioaktive.
- b. Nese një aprovim importi ,ose eksporti per burime radioaktive, ka qene i ndaluar per pritesin ne vendin importues ,ose nese pritesi ose vendi importues ka ndryshuar qellimi i elementeve te Udhezuesit te ndonje importi ose eksporti te materialeve radioaktive, te cilat kane qene te aprovuara paraprakisht.
- c. Riskun e diversionit ose akteve keqberese qe perfshijne materiale radioaktive.

## Neni 5

### Njoftimi perpara dergimit

1. Pas marrjes ne konsiderate te informacioneve te mesiperme dhe shqyrtimit te tyre , KMR vodos te aprovoje eksportin, si dhe te marre hapat e pershtatshem per te siguruar qe:

- a. Eksporti i burimit eshte bere ne përputhje me stadartet nderkombetare egzistuese qe lidhen me transportin e sigurte te materialeve radioaktive,dhe
- b. Vendit importues eshte njoftuar me shkrim perpara cdo dergese me informacionin e meposhtem:

- i. Data e perafert e eksportit
  - ii. Qendra eksportuese.
  - iii. Pritesin
  - iv. Radionuklidet dhe radioaktivitetin.
  - v. Aktivitetin e grupimit dhe
  - vi. Numrin e burimeve radioakteve dhe numrin unik te identifikimit
2. Ky njoftim mund te jepet nga KMR ose qendra eksportuese. Nëse njoftimi jepet nga qendra eksportuese , një kopje duhet ti dergohet KMR-se te pakten 7 dite me perpara dergimit te burimeve.. Ky njoftim duhet te shoqerohet nga një kopje e aprovimit te dhene.

## APROVIMI I EKSPORTIT.

### KATEGORIA 2 E BURIMEVE RADIOAKTIVE(KMR) (Te ndryshme nga percaktimet e vecanta)

#### Neni 6 Procedura e aprovimit të eksporteve

1. KMR nepermjet ketij Udhezuesi vendos procedura te aprovimit te eksportave per burimet e Kategorise 2 te ndryshme nga rastet e percaktiveve te vecanta. Si vend eksportues KMR, ose qendra eksportuese duhet ti jape informacion vendit importues.
2. Per te vodosur aprovin e eksportit, KMR duhet te sigurohet qe pritesi te jete i licensuar nga vendi importues per te marre dhe perdorur burimin ne perputhje me ligjet dhe rregulloret e tij.Ky aprovim nga KMR te bazohet ne konfirmimin nga vendi importues qe pritesi eshte i licensuar per te marre dhe perdorur burimin, ose burimet qe do ekportohen, ose te paraqese një kopje te licenses.
3. KMR rishikon informacionin e meposhtem:
  - a. Emrin e Pritesit
  - b. Vendodhjen dhe adresen ose vendin kryesor te biznesit.
  - c. Radionuklidet dhe radioaktivitetin
  - d. Perdorimin ,nqs eshte e pershtatshme
  - e. Daten e skadimit te licences.
4. KMR sigurohet qe vendi importues ka kapacitetet administrative dhe teknike te pershtatshme per burimet dhe strukturen regullatore per te menaxhuar burimet. Vleresimi nga ana e KMR-se bazohet ne faktin qe vendi importues ka vodosur kornizen regullatore qe perfshin Kategorine 1 dhe 2 te burimeve radiakte, e cila ka ne funksion elementet e meposhtem:
  - a. Legjislacionin e mbrojtjes nga rrezatimet dhe rregulloret perkatese
  - b. Percaktimin e trupes rregullatore
  - c. Krijimin e nje regjistri kombetar ose inventarin e burimeve radioakte
  - d. Krijimin e sistemit te njoftimit, licensimit dhe kontrollit te materialeve radioakte.
5. Përvec kërkesave të mesiperme, KMR mund te marre ne konsiderate per vleresim dhe informacionin e meposhtem :
  - a. Pergjigjen nga vendi importues per pytesorin e vete-vleresimit(ANE).
  - b. Nese vendi importues ka shprehur per Drejtorin e Pergjithshem te ANE qe po punohet ne zbatim te Kodit te Drejtimit dhe Udhezesit perkates te ANE.
  - c. Nese vendi importues qe ka marre pjese ne Projekt Modelin e ANE's per Ngritjen e Infrastrukturies se Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe ka plotesuar piken e pare te ketij projekt
6. Per vleresimin ne lidhje me 'aprovimin e eksportit, KMR merr në konsiderate edhe këto informacione:
  - a. Nese pritesi ka qene i perfshire ne prokurime ilegale ose klandestine te materialeve radioakteve.
  - b. Nese një licencim importi, ose eksporti per burime radioakteve ,ka qene i ndaluar per pritesin ne vendin importues ,ose nese pritesi ,ose vendi importues ka ndryshuar qellimisht elemente te

Udhezuesit te ndonje importi, ose eksporti, te materialeve radioaktive te cilat kane qene te licensuara paraprakisht.

- c. Riskun e diversionit ose akteve keqberese qe perfshijne materiale radioaktive.

### Neni 7 Njofthimi perpara dergimit

1. Nëse pas marrjes ne konsiderate te informacioneve te mesiperme dhe marrjes se aprovimit, KMR vendos te aprovoje ekportin, si dhe te marre hapat e pershtatshem per te siguruar qe:

- a. Eksporti i burimit eshte bere ne perputhje me standartet nderkombetare egzistuese qe lidhen me transportin e sigurte te materialeve radioaktive,dhe
- b. Vendi importues eshte njofthuar me shkrim perpara edo dergese me informacionin e meposhtem:
  - i. Data e perafert e eksportit
  - ii. Qendra eksportuese.
  - iii. Pritesin
  - iv. Radionuklidet dhe radioaktivitetin.
  - v. Aktivitetin e grupimit dhe
  - vi. Numrin e burimeve radioaktive dhe numrin unik te identifikimit

2. Ky njofthim mund te jepet nga KMR ose qendra eksportuese. Nqs njofthimi jepet nga qendra eksportuese nje kopje duhet ti dergohet KMR te pakten 7 dite perpara dergimit te burimeve.. Ky njofthim duhet te shoqerohet nga nje kopje e aprovimit te dhene.

### APROVIMI I IMPORTIT (KMR)

#### Neni 8 Procedura e aprovimit te importit

1. KMR, si importues, vendos procedura per aprovimin e importeve te burimeve radioaktive te kategorise 1 dhe 2. Per aprovimin e importit te tyre, KMR duhet te :

- a. Siguroje qe pritesi eshte i licencuar per te marre dhe perdonur burimin ne perputhje me ligjin dhe rregulloret e Republikes se Shqiperise
- b. Siguroje qe Subjekti ka kapacite te pershtatshme teknike dhe administarative per menaxhimin e burimit/burimeve. Kjo bazohet ne faktin qe KMR ka te percaktuar kornizen regullatore e cila mbulon burimet e gjithe kategorive ,si dhe mban inventarin e burimeve radioaktive ne rang kombtar.

2. Shqiperia ka plotesuar piken e pare te Model Projektit me ANEA.

2.Per te aprovuar Importin, KMR merr ne konsiderate informacionin neqe:

- a. Pritesni qe perfshire ne prokurime ilegale ose klandestine te materialeve radioaktive.
- b. Nese nje aprovim importi, ose eksporti, per burime radioaktive ka qene i ndaluar per pritesin ne Shqiperi ,ose nese pritesi ka ndryshuar qellimi qe elemente te Udhezuesit te ndonje importi ,ose eksporti te materialeve radioaktive, te cilat kane qene te licensuara paraprakisht.
- c. Riskun e diversionit ose akteve keqberese qe perfshijne materiale radioaktive.

3. Kur KMR vendos te aprovoje importin, duhet te marre hapat e nevojshem per te siguruar qe :

- a. Nje kopje e Licences se pritesit ,ose konfirmimit te KMR-se qe pritesi eshte i autorizuar per te marre dhe perdonur burimin ose burimet qe do te eksportohen , i eshte dhene vendit eksportues ose qendres eksportuese.
- b. Nje kopje e aprovimit te importit i eshte dhene vendit eksportues ne rastin kur kerkohet nga vendi eksportues dhe
- c. Importi i materialeve radioaktive eshte realizuar ne perputhje me standartet nderkombetare ekzistuese ne lidhje me transportin e sigurte te materialeve radioaktive .

## **PERCATIMET E VECANTA**

### **Neni 9 Kushtet e vecanta**

1. Nqs ky Udhezues nuk mund te zbatohet ne lidhje me nje import ,ose eksport,KMR mund te marre ne konsiderate nese import-eksporti mund te aprovohet ne kushte te vecanta . Ne keto kushte,KMR merr ne konsiderate dhe te mirat qe vijne nga nje import/ eksport i tille. Nqs KMR vendos qe te tilla "kushte te vecanta" ekzistojne, KMR mund te marre aprovimet perkatese.

2. Si kushte te vecanta konsiderohen:

- a. Rastet e konsiderueshme te shendetit ,ose nevojat mjekesore ,te njohura nga vendi importues dhe vendi eksportues.Ne te tilla raste vendi importues dhe KMR duhet te beje marreveshje perpara licensimit te eksportit per sigurine dhe sigurimin e burimeve radioaktive gjate gjithe kohes se perdonimit .
- b. Rastet kur kemi te bejme me nje rrezik radiologjik ose kercenim te sigurise te nje ose me shume burimeve ose ,
- c. Rastet ne te cilat qendra eksportuese ose KMR mban nen kontroll burimin/burimet radioaktive gjate periudhes qe burimi/ burimet jane jashte vendit dhe qendra eksportuese, ose KMR zhvendos burimin/burimet ne fund te kesaj periudhe .

### **Neni 10 Kerkese per aprovim**

1. Kërkesa e KMR-se për aprovim të eksportit të burimeve në kushte te vecanta për vendin importues duhet të përmbajë;

- a. Emrin e Pritesit
- b. Vendodhjen dhe adresen ,ose vendin kryesor te biznesit.
- c. Radionuklidet dhe aktivitetin
- d. Numer identifikues unik per kerkesen
- e. Afatin kohor per te vendosur per perqjigjen.

### **Neni 11 Tranzitin dhe tranzitin detar**

Shqiperia merr ne konsiderate transportin e burimeve radioaktive nepermjet territorit te ndonje vendi tjeter te ndryshem nga vendi importues ,ose vendi eksportues,megjithese nje transport i tille nuk eshte subjekt i parashikimeve per licensimin e eksportit, ose importit te ketij Udhezuesi .

### **Neni 12 Informacione ndihmëse**

1. Per te lethesuar kohen e rishikimit te kerkeses per eksport ,KMR ka plotesuar dhe derguar ne ANEA perqjigjen e tij per PyetSORIN e VeteVleresimit dhe ka dhene pelqimin per shpendarje vendeve te tjera.

2. Pika e kontaktit per Republiken e Shqiperise pika e Kontaktit per shkembimin e infomacionit per import eksportet do te jetë Zyra per Mbrojtjen Nga Rezatimet me adresë:

Rr. "A Moisiu" No 80 Tirana ALBANIA  
Personi i Kontaktit Rustem PACI  
Tel +355 42 37 00 57  
Fax; + 355 42 37 00 58  
Email [rpaci@moh.gov.al](mailto:rpaci@moh.gov.al)